

# Standardet Minimale Ndërkombëtare për zhvillimin e politikave për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve tek lëvizjet kombëtare të Scripture Union

*Të lexohet së bashku me Synimet, Besimet dhe Parimet e Punës së SU-së;  
Shërbimi për Fëmijët dhe të Rinjtë në SU (të dyja të disponueshme në ekstranetin SU-së  
Globale) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC)*



Përmbledhje \_\_\_\_\_

Pasqyra e Lëndës

<b>Hyrje</b> .....	2
<b>Pjesa e parë:</b> Deklarata e SU-së për përkushtimin tonë ndaj fëmijëve.....	3
<b>Pjesa e dytë:</b> Mbrojtja e fëmijëve.....	4
A. Procedurat e rekrutimit për stafin dhe vullnetarët .....	4
B. Sigurimi i standardeve të larta .....	4
C. Kodi i mirësjelljes për stafin dhe vullnetarët e Scripture Union.....	5
D. Procedurat në rastin e abuzimit të zbuluar ose të pohuar .....	6
E. Mbrojtja e fëmijëve tek komunikimet e SU-së .....	8
F. Puna me partnerët.....	8
<b>Pjesa e Tretë:</b> Siguria .....	9
A. Sigurimi i standardeve të larta.....	9
B. Kodi i Mirësjelljes për Stafin dhe Vullnetarët e Scripture Union.....	10
<b>Pjesa e katërt:</b> Zhvillimi dhe zbatimi i politikës për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve brenda SU.....	11
<b>Përmbyllje:</b> Shtojcat 1 - 5 .....	12

*Ky rishikim është aprovuar nga Bordi Global i Scripture Union International në shtator 2018.*

*Është adaptuar nga Bordi i Scripture Union Kosova në tetor 2020.*

Ky udhëzues është një pjesë e Strategjisë Misionare Globale të SU International dhe është hartuar nga Bordi Global i Scripture Union si një rekomandim për standardet minimale për Mbrojtjen, Sigurinë dhe Përkujdesjen e Fëmijëve (CPSC) në të gjitha lëvizjet e SU-së nëpër botë.

Aktualisht ekzistojnë variacione të ndryshme ndërmjet dhe brenda Grupeve / Lëvizjeve të Komunitetit të SU-së në lidhje me standardet e mbrojtjes, sigurisë dhe përkujdesjes së fëmijëve. Duke siguruar një kornizë të fushave kryesore për t'u marrë në konsideratë, ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë Këshillat / Bordet e SU-së dhe organet drejtuese, për të zhvilluar dhe zbatuar një politikë për mbrojtjen e fëmijëve për lëvizjen e tyre.

Bordi Global i Scripture Union pret që lëvizjet e SU-së në të gjithë botën urgjentisht të zhvillojnë dhe zbatojnë ose rishikojnë një politikë për mbrojtjen e fëmijëve që është e përshtatshme për kontekstin e tyre dhe në përputhje me parimet e mëposhtme dhe standardet minimale. Kur lëvizjet kanë tashmë në zbatim një politikë për mbrojtjen e fëmijëve, ky udhëzues ka për qëllim të sigurojë një mekanizëm kontrollues.

Mbrojtja, siguria dhe përkujdesja e fëmijëve është përgjegjësi e të gjithëve. Është detyrim yni si të Krishterë dhe pjesë e angazhimit të SU-së për mirëqenien emocionale, fizike, intelektuale dhe shpirtërore të fëmijëve nën përkujdesjen tonë. Është më tepër sesa një përmbushje e standardeve minimale ligjore për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Këto Udhëzime të politikës për mbrojtjen e fëmijëve pasqyrojnë parimet e punës të SU-së, të cilat thonë se “Ne synojmë t’ju tregojmë fëmijëve Lajmin e Mirë të Zotit... jo vetëm me fjalë por duke ndërtuar marrëdhënie të përkujdesjes me ta” dhe... “ne kemi një përgjegjësi të veçantë ndaj fëmijëve ... të cilët... shfrytëzohen”.

Për më tepër, ato gjithashtu pasqyrojnë qëllimin dhe standardet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës. Këto të drejta përfshijnë: “mbrojtje nga të gjitha format e abuzimit të fëmijëve, neglizhencës, shfrytëzimit dhe mizorisë”.<sup>1</sup>

Në këto udhëzime, termi ‘fëmijë’ i referohet çdo personi të ri nën moshën 18 vjeç. **Megjithatë, mund të përfshihen edhe personat e cenueshëm që janë nën moshën 25 vjeç (p.sh. njerëz me aftësi të ndryshme të kufizuara).**

Këto udhëzime sigurojnë që një lëvizje do të:

1. Mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e të gjithë fëmijëve, vullnetarëve dhe stafit që janë të ndërlidhur me Scripture Union.
2. Hulumtojë kontekstin e vet kombëtar duke përfshirë detyrimet kombëtare dhe politikën për mbrojtjen e fëmijëve të agjencive të tjera me fokus fëmijët
3. Zhvillojë një politikë për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve e cila do të zbatohet në të gjitha nivelet dhe në të gjitha aktivitetet brenda Scripture Unionit.
4. Njihet me mënyra praktike për të parandalimin e abuzimit të fëmijëve brenda aktiviteteve të SU-së si dhe për t’i adresuar pretendimet ose zbulimin e abuzimit të fëmijëve që mund të ndodh në një aktivitet të SU-së.
5. Vendors standarde të larta dhe të avokojë për mbrojtjen e fëmijëve në shtetin ose rajonin e tyre dhe në mesin e agjencive të tjera që punojnë me fëmijët.

---


<sup>1</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës (UNCRC 1989). Shih po ashtu dokumentin e bashkëngjitur.

## Pjesa e parë

### Deklarata e Scripture Union për përkushtimin tonë ndaj fëmijëve

SU beson se çdo fëmijë është një qenie njerëzore unike e krijuar në imazhin e Zotit dhe meriton dashurinë dhe respektin.

#### 1. Çdo fëmijë duhet të jetë i sigurt fizikisht.



Prandaj, ne do të sigurojmë që të ekzistojnë procedurat e duhura për parandalimin e abuzimit fizik dhe seksual dhe inkurajimin e praktikës së sigurt.

Çdo lëvizje kombëtare duhet të jetë e njohur me kërkesat e fundit të legjislacionit të 'detyrës së kujdesit' të përcaktuara nga qeveritë e tyre kombëtare dhe lokale.

#### 2. Çdo fëmijë duhet të jetë i sigurt emocionalisht.



Prandaj, ne do të punojmë për të siguruar që çdo fëmijë të ndihet i vlerësuar dhe i përfshirë dhe se mendimet e tij / saj të dëgjohen dhe respektohen.

#### 3. Çdo fëmijë është unik në aftësinë dhe ritmin e zhvillimit intelektual të tij / saj, në prejardhjen e tij / saj kulturore dhe familjare dhe në besimin ose prapavinë e kishës së tij / saj.



Prandaj ne do t'i vlerësojmë dallimet individuale dhe do t'i mbrojmë fëmijët nga talljet ose paragjykimet. Ne do të jemi të ndjeshëm ndaj prejardhjes kulturore të secilit fëmijë në zgjedhjen e gjuhës dhe veprimtarive tona, dhe në mënyrën se si i përdorim ato. Ne do të respektojmë dëshirat dhe të drejtat e prindërve dhe kujdestarëve të tyre.

#### 4. Çdo fëmijë meriton ta përjetojë Lajmin e Mirë të Jezus Krishtit.



Prandaj ne do të kërkojmë të pasqyrojmë kujdesin e Zotit ndaj të gjithë fëmijëve në çdo kohë. Ne do ta paraqesim mesazhin e Zotit pa manipulime, mosdurim ose presion.

## Pjesa e dytë

---

### Mbrojtja e fëmijëve

#### A. Procedurat e rekrutimit për stafin dhe vullnetarët

Marrëdhëniet e shëndosha janë themeli i aktiviteteve të SU-së. Sidoqoftë, ne jemi të vetëdijshëm se ka të atillë që mund të kërkojnë t'i përdorin aktivitetet e SU-së për të shfrytëzuar fëmijët. Për të minimizuar këtë dukuri, Scripture Union mbetet e përkushtuar ndaj këtyre udhëzime të kujdesshme gjatë rekrutimit të stafit dhe vullnetarëve të saj:

1. Bëhet kontrollimi i pavarur i referencave të karakterit duke marrë parasysh kujdesin e shtuar në çështjen e konfidencialitetit dhe privatësisë.
2. Kërkohen Certifikatat e Penalitetit të Policisë dhe Gjykatës (aty ku është e mundur ose kërkohet ligjërisht).
3. Pranimi në punë është i kushtëzuar që personi ta nënshkruajë Deklaratën se ai e ka kuptuar dhe bie dakord të pajtohet me Politikën e Mbrojtjes, Sigurisë dhe Përujdesit të Fëmijëve. Kjo kopje do të ruhet.<sup>2</sup>
4. Për më tepër, në rastin e rekrutimit të personelit, SU do të zhvillojë një intervistë që përcakton përshtatshmërinë e personit ndaj punës me fëmijë dhe / ose adoleshentë. Si një mbrojtje, provat e përvojës, karakterit dhe kualifikimeve do të hulumtohen dhe do të bëhen hetime për çdo shqetësim.
5. Do të plotësohen të gjitha kërkesat ligjore.

Ndërsa përgjegjësia kryesore e SU-së është mirëqenia e fëmijës, nuk do të rekrutohet askush me një histori të mëparshme të njohur të pedofilisë, abuzimit të fëmijëve ose veprave të ngjashme.

#### B. Sigurimi i standardeve të larta

Ndërsa shërbesa e SU-së shpreh zemrën e dashur të Zotit, ne jemi të thirrur të kujdesemi dhe të respektojmë fëmijët në të gjitha aktivitetet e SU-së. Prandaj, SU do të marr hapa për të siguruar që:

1. Fëmijët trajtohen me dinjitet. Favorizimi, ngacmimi dhe diskriminimi nuk do të tolerohen brenda asnjë aktiviteti të SU-së.
2. Respektohet e drejta e fëmijës për privatësi.
3. Nuk do të tolerohet kurrë asnjë kontakt fizik i papërshtatshëm me fëmijët.
4. Aktivitetet nuk shfrytëzojnë dallimet gjinore, fizike, kulturore ose intelektuale, por japin mesazhe pozitive rreth larmisë njerëzore.
5. Disiplina do të bëhet në kontekstin e dashurisë dhe do të modelojë vlerat biblike të faljes dhe restaurimit. Disiplina nuk do të përfshijë asnjëherë poshtërim qoftë privatisht, qoftë publik.
6. Si rregull e përgjithshme, grupet e përziera do të kenë si udhëheqës meshkuj dhe femra. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për aktivitetet rezidenciale.
7. Alkooli dhe drogat e paligjshme ose të papërshtatshme janë të ndaluara në të gjitha aktivitetet e SU-së.
8. Të gjithë udhëheqësit e SU-së (stafi dhe vullnetarët) janë trajnuar për t'u marrë me sjelljen e duhur ndaj fëmijëve dhe për të njohur dhe adresuar abuzimin nga kolegët, dmth abuzimin e fëmijëve kundër njëri-tjetrit. I gjithë stafi dhe vullnetarët e SU-së janë të njohur me procedurat që duhet të miratojnë kur një fëmijë zbulon abuzimin ose një person pretendon se ka abuzim në një ngjarje të SU-së. Ata e kuptojnë detyrimin e tyre për të raportuar menjëherë çdo dyshim ose pretendim në lidhje me abuzimin ose dëmtimin ose çdo zbulim që një fëmijë mund të ketë bërë. Kjo përfshin abuzimin nga fëmija në fëmijë.
9. I gjithë stafi dhe vullnetarët e SU-së e kuptojnë detyrimin e tyre për të zbuluar ndonjë përvojë të mëparshme që mund t'i skualifikojë ata për të punuar me fëmijë në SU.

---

<sup>2</sup> Shih Shtojcën 2 për Shembullin e Deklaratës së stafit për mbrojtjen e fëmijëve dhe Formularin e vullnetarëve.

### C. Kodi i mirëgjelljes për stafin dhe vullnetarët e Scripture Union

SU pret që udhëheqësit e saj të shfaqin standarde të larta të sjelljes ndaj fëmijëve dhe ndaj njëri-tjetrit, në përputhje me pozicionin e tyre si modele pozitive dhe ndërtuese të miqësisë.

Drejtimesit e SU-së do të bien dakord për standarde të larta të sjelljes ndaj fëmijëve dhe zotohen si vijon:

1. Kurrë nuk do të lejojnë ose të përfshihen në asnjë prekje të papërshtatshme. Ata do të shmangin kontaktin e afërt ose të largët fizik me fëmijët.
2. Kurrë nuk do të flasin fjalor seksual ose gjeste sugjeruese seksuale ndaj një fëmije as të luanë lojëra sugjestionuese seksuale.
3. Kurrë nuk do të veprojnë në mënyra që turpërojnë ose nënçmojnë fëmijët.
4. Kurrë nuk do përdorin gjuhë fyese ose abuzive.
5. Kurrë nuk do të lejojnë që fëmijët që përdorin gjuhë ofenduese ose abuzive të kalojnë pa u sfiduar dhe as të përfshihen në ngacmime ose veprime tjera abuzive ndaj fëmijëve të tjerë. Kjo përfshin abuzimin fëmijë – fëmijë duke përfshirë mediet sociale p.sh. ngacmimi në internet ose shfaqja e fotove ose mesazheve të papërshtatshme.
6. Kurrë nuk do ta disiplinonjë një fëmijë duke përdorur ndëshkimin fizik që përfshin goditjen e një fëmije ose privimin e tij nga ushqimi ose shtrati. Kufizimet fizike mund të përdoren kur një fëmijë është në rrezik ose nëse veprimet / sjellja e një fëmije mund t'i shkaktojë lëndim një personi tjetër.
7. Kurrë nuk do të bëjmë gjëra të një natyre personale për fëmijët që ata mund t'i bëjnë vetë.
8. Kurrë nuk do të kalojmë kohë vetëm me një fëmijë (ose një grup të vogël fëmijësh) larg të tjerëve. Gjithmonë do të sigurohemi që çdo ndërveprim të jetë në vështrimin e të tjerëve.
9. Si rregull e përgjithshme, kurrë nuk do ta këshillojmë<sup>3</sup> një fëmijë të gjinisë së kundërt.
10. Si rregull e përgjithshme, kurrë nuk do të hyjmë në dhomën e ndërrimit të rrobave ose në dhomën e fjetjes së fëmijëve të gjinisë së kundërt. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët më të rritur.
11. Do të sigurohemi që të gjitha ndërveprimet me fëmijët të ndodhin në atë mënyrë saqë qëllimet e udhëheqësit të mos mund të keqinterpretohen nga fëmija ose nga të tjerët. Të gjitha komunikimet midis fëmijëve dhe drejtuesve duhet të jenë të hapura, transparente dhe jo-përrjashtuese. Asnjëherë mos flisni me një fëmijë ose fëmijë pas dyerve të mbyllura.
12. Në rast se kontakti individual duket i përshtatshëm për një arsye të caktuar, atëherë paraprakisht duhet të këshillohet prindi-rit dhe/ose udhëheqësi i lartë përkatës i SU-së. Kjo vlen edhe për internetin / postën elektronike, telefonat fiks ose celularë dhe të gjithë kontaktet e mediave sociale.
13. Kurrë nuk do ta përdorim pozicionin tonë të miqësisë ose autoritetit për ta manipuluar një fëmijë drejt një pranimi të veçantë të krishterë.

---

<sup>3</sup> Në këtë kontekst, “këshillim” nënkupton përfshirje në bashkëbisedim personal – qoftë një-me-një ose një fëmijë dhe një ose më tepër drejtues të tjerë

## D. Procedurat në rastin e abuzimit të zbuluar ose të pohuar

Abuzimi i fëmijëve lulëzon në një atmosferë sekrete. Për këtë arsye, SU duhet të njihet për karakterin e saj të transparencës ku fëmijët dhe të rriturit ndjehen të lirë të ngrenë shqetësime në lidhje me çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë duke ditur që të gjitha shqetësimet do të merren seriozisht dhe se konfidencialiteti do të respektohet.

SU do të njihet si një organizatë që:

1. Njeh dhe ju përmbahet në mënyrë rigorozë kërkesave ligjore. Në disa vende, ligjet në lidhje me zbulimin e abuzimit ja imponojnë SU-së detyrimin që të raportojë tek autoritetet përkatëse dhe të mos ndërmerr asnjë veprim të mëtutjeshëm.
2. Ndërmerr hapa pozitivë për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve që janë objekt i atyre shqetësimeve.
3. Mbështet fëmijët, stafin, vullnetarët ose të rriturit e tjerë që ngrenë shqetësime ose që janë subjekt i shqetësimit.
4. Vepron menjëherë, në mënyrë të përshtatshme dhe efektive në kryerjen e një hetimi të fuqishëm dhe / ose bashkëpunimin me çdo proces të mëvonshëm hetimor.
5. I ruan me konfidencë procesverbalet e të gjitha ankesave / zbulimevet dhe veprimet e ndërmarra.

### a. Zbulimi nga një fëmijë: Procedurat që duhen ndjekur

Në rast se një fëmijë zbulon ndonjë lloj abuzimi para një anëtari të SU-së (në lidhje me shtëpinë, kishën, shkollën, SU-në), ka disa procedura që duhet të ndiqen nga të gjithë personat e përfshirë:

1. Mos i premtoni konfidencialitet fëmijës – sapo të fillojë biseda gjithmonë paralajmëroni fëmijën se dikush tjetër do të duhet të vihet në dijeni për këtë. Në shumë shtete mos raportimi i këtyre shkeljeve të zbuluara tek Policia, përbën shkelje ligjore. Prandaj, nëse kjo qëndron, fëmija duhet të informohet për këtë dhe të këshillohet për të gjitha vijimësitë.
2. Nëse fëmija dëshiron ta vazhdojë tregimin e vet, dëgjoje duke e ruajtur qetësinë.
  - a) Mos e gjykoni paraprakisht dhe mos e banalizoni çështjen.
  - b) Mos bëni pyetje kryesore ose mos e bëni fëmijën të përsërisë historinë pa nevojë.
  - c) Sigurojeni fëmijën se ai / ajo nuk ka bërë asgjë të keqe.
3. Mbjaj shënime për gjërat që ke parë, vëzhguar ose që janë thënë.
4. Ndërmerr veprim të menjëhershëm: personitë cilit i janë raportuar këto gjëra, duhet t'ia raportojnë ato menjëherë tek drejtuesi më i lart i cili është përgjegjës specifik për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve, i / e cili më pas do të vendos për hapat e nevojshëm që duhet ndërmarr.
5. Mbështetni fëmijën sa më tepër që të jetë e mundur. Ky është një proces traumatik dhe fëmija mund të përjetojë emocione dhe besueshmëri të përziera, që kërkojnë mirëkuptim. Kjo mund të nënkuptojë kërkimi i ndihmës nga specialistët për të ofruar shërbime maksimale të këshillimit për fëmijën dhe familjen.
6. Ata që janë të informuar për zbulimin e rastit, duhet ta ruajnë atë me konfidencë të rreptë.

### b. Ankesat për abuzim në ndonjë aktivitet të SU-së: Procedurat që duhen ndjekur

*Kur një udhëheqës i SU-së në një aktivitet / ngjarje të SU-së akuzohet për ndonjë gjë tjetër përveç një çështjeje të vogël<sup>4</sup>:*

1. Ai person duhet të largohet nga aktiviteti derisa të qartësohet natyra e situatës dhe të vendoset për veprime të mëtejshme. Personi duhet të trajtohet me respekt dhe drejtësi dhe do të prezumohet të jetë i pafajshëm përveç nëse dhe derisa të vërtetohet fajësia.
2. Personi që ngre pretendimin, do të intervistohet nga udhëheqësit e SU-së që kanë përgjegjësi të veçantë për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve.
3. Në rast se ankesa duket se është e bazuar:
  - a) Drejtori Kombëtar ose personi i lartë i caktuar nga Drejtori Kombëtar do të sigurojë që çdo shqetësim ose çështje, të adresohet në mënyrë efektive dhe të procedohet tek autoritetet përkatëse siç parashihet me ligj. Në të njëjtën kohë duhet të demonstron dhembshuria e krishterë ndaj shkelësit të dyshuar.
  - b) Nëse personi tregohet se ka kryer një veprim të abuzimit seksual ose serioz fizik ose emocional të fëmijëve, ai person nuk do të lejohet më të jetë në ndonjë aktivitet të SU-se e as të ushtrojë ndonjë funksion në SU. Kjo masë disiplinore është e ndarë prej procedurave ligjore që mund të ndërmerren. Ne besojmë se komuniteti pret nga ne një rol serioz dhe të vazhdueshëm në përpjekjen për të siguruar që shkelësit e ligjit të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre, duke respektuar në të njëjtën kohë të drejtën e personit për konfidencialitet.
  - c) Do t'i ofrohet mbështetje fëmijës dhe familjes së përfshirë.
  - d) Të tjerëve në SU dhe komunitetit më të gjerë mund t'u nevojitet mbështetje për t'u marrë me situatën.
  - e) Në rastet që kjo është e mundur, SU do të përpiqet të sigurojë që shkelësit t'i ofrohet kujdes baritor dhe ndihmë profesionale përmes rrjeteve ose agjencive të jashtme.
4. Në rastet kur ankesa vërtetohet se është e pabazuar, SU do të bëjë të gjitha që është në fuqinë e saj për ta pastruar emrin e personit të përfshirë. Scripture Union është e përkushtuar për t'i mbrojtur të gjithë ata që punojnë me fëmijë prej pasojave e akuzave të pabazuara.

Procedurat e mësipërme zbatohen edhe në rastet kur kemi të bëjmë me abuzim shpirtëror. Edhe kjo është një çështje serioze dhe duhet të trajtohet në trajnimet tona. Të gjitha aktivitetet tona duhet të demonstronjë një mungesë manipulimi, që është thelbësore për punën e SU-së me fëmijët dhe është i nënkuptuar tek *Synimet, Besimi dhe Parimet e Punës së SU-së* dhe tek *Dokumenti i Politikës së SU: Shërbimi për Fëmijët dhe të Rinjtë në Scripture Union*. Aty ku abuzimi shpirtëror vazhdon, personi i përfshirë duhet të përjashtohet nga bashkëveprimi me fëmijët.

Në rastet kur personi i akuzuar për abuzim është një fëmijë tjetër, kjo kërkon shkathtësi të veçanta dhe duhet të merret parasysh fakti që të dy fëmijët e përfshirë janë të mitur. Drejtori Kombëtar ose një person i lartë i caktuar nga Drejtori Kombëtar duhet të përfshihen në proces që nga fillimi. Intervistat e thelluara nuk duhet të bëhen derisa të zbulohen të gjitha kërkesat ligjore dhe të kërkohet ndihma e specialistëve.

*Në rastet kur Drejtori Kombëtar është personi i cili është subjekt i pretendimit, Kryesuesi i Bordit të SU-së do të marrë përgjegjësinë për të proceduar çështjen.*

---

<sup>4</sup> Një çështje e vogël konsiderohet ajo çështje që një kërkim falje e sinqertë është adekuate dhe e duhur, p.sh. përdorimi i fjalëve të rënda. Çdo dyshim për ndonjë prekje të papërshtatshme ose sygjestionet, nuk mund të konsiderohen çështje të vogla.

*Në rastet kur vërehet se një fëmijë duket se ka simptoma të neglizhencës serioze, Drejtori Kombëtar ose një person i moshuar i caktuar nga Drejtori Kombëtar këshillohet që t'ia kaluar këtë rast autoriteteve përkatëse.*

*Shikoni Shtojcën 3 për Shabllonin e Formularit të Raportimit që do të përdoret për zbulimin ose pretendimin e abuzimit*

## E. Mbrojtja e fëmijëve tek komunikimet e SU-së

Të gjitha komunikimet – siç janë historitë, artikujt dhe imazhet – duhet ta mbrojnë dinjitetin dhe privatësinë e fëmijëve.

1. Kujdes duhet të ushtrohet në çdo kohë në përdorimin dhe shpërndarjen e fotografive të fëmijëve që kanë marrë pjesë në ngjarjet e SU-së, sidomos kur nuk kemi kontroll mbi përdorimin përfundimtar (si p.sh. në faqet e internetit).
2. Kërkesat ligjore, veçanërisht në lidhje me lejen e prindërve, duhet të njihen dhe respektohen.
3. Përmendja paraprake duhet të bëhet dhe lejet duhet të sigurohen për fotografitë ose videot e bëra në një aktivitet të fëmijëve të SU-së që mund të qarkullojnë nëpër mediat sociale.
4. Duhet vendosur kufizime për bërjen e fotografive dhe videove të fëmijëve që ruhen nëpër celular dhe çdo pajisje tjetër elektronike.
5. Të gjitha aspektet e sipërpërmendura janë të shkruara tek Politika Mediale të një lëvizjeje të SU-së.

## F. Puna me partnerët

Scripture Union punon me shkolla, kisha, agjenci të krishtera dhe organizata të tjera jo-qeveritare ose qeveritare.

SU angazhohet të punojë në partneritet me organizata të tilla sipas standardeve të dakorduara të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Përkujdesjes së Fëmijëve, që janë në përputhje me politikën e vetë SU-së. Kur kishat ose organizatat tjera janë duke punuar me SU-në në një aktivitet të SU-së, atëherë SU do t'i zbatojë standardet e veta sipas Procedurave të Rekrutimit për Personelin dhe Vullnetarët (Pjesa 2 Seksioni A më lart).



## Pjesa e Tretë

---

### Siguria

#### A. Sigurimi i standardeve të larta

Aktivitetet e Scripture Union krijojnë argëtim dhe aventurë për fëmijët. Në të njëjtën kohë, ne jemi të përkushtuar ndaj praktikave që i mbajnë të gjithë fëmijët të sigurt nga rreziku i mundshëm. Prandaj është përgjegjësia jonë të njohim rreziqet që shoqërojnë çdo aktivitet dhe të marrim vendimet e duhura në lidhje me menaxhimin e atyre rreziqeve. Detyrimi ynë është të zbatojmë standarde të larta të përgatitjes dhe kujdesit në të gjitha aktivitetet.

Kjo do të thotë që në të gjitha aktivitetet e veta, SU do të ndërmarrë hapa për të siguruar që:

1. Objektet e përdorura (qoftë SU apo të tjera) përmbushin standardet minimale të sigurisë të parashikuara me ligj dhe nga detyrimi ynë, për t'i mbajtur fëmijët të sigurt.
2. Ekzistojnë masa paraprake dhe mbikëqyrje të përshtatshme e sigurisë në çdo kohë siç parashihet me ligj dhe nga detyrimi ynë për t'u përkujdesur. Të gjitha pajisjet e përdorura nga ose përreth fëmijëve mbahen në gjendje të mirë dhe kontrollohen rregullisht për sigurinë.
3. Formularët e pëlqimit / lejes së prindit / kujdestarit nënshkruhen kur është e përshtatshme.
4. Rreziqet e përfshira në çdo aktivitet të lidhur me fëmijën janë konsideruar me kujdes dhe janë ndërmarrë veprimet e duhura për të minimizuar rrezikun ose për të ndryshuar aktivitetin.
5. Raporti i të rriturve ndaj fëmijëve është mjaft i lartë sa për të minimizuar dëmin dhe për të maksimizuar marrëdhëniet pozitive. Në shumë shtete, raporti i rekomanduar është 1 udhëheqës për 5 fëmijë (nën moshën 8 vjeç) dhe 1 udhëheqës për 8 fëmijë (mbi moshën 8 vjeç). Çdo lëvizje kombëtare duhet të pajtohet me një raport të përshtatshëm duke marrë parasysh kërkesat ligjore dhe praktikën e agjencive të ngjashme me fokusin tek fëmijët.
6. Procedurat e sigurisë për t'u ndjekur në rast zjarri, aksidenti ose rreziqesh specifike për vendndodhjen janë në zbatim dhe të gjithë udhëheqësit janë të njohur me to.
7. Politikat shëndetësore qeveritare që kanë të bëjnë me sëmundjet ngjitëse janë të njohura dhe duke u përfillur.
8. Ekziston një politikë e ofrimit të Ndhmës së Parë që përfshin:
  - a) Kërkimi i informacionit përkatës mjekësor për fëmijët nëpër aktivitetet tona rezidenciale.
  - b) Emërimi i një udhëheqësi për secilën aktivitet që do të bart përgjegjësinë për çështjet mjekësore. Ky person mund të mos jetë një profesionist shëndetësor, por duhet të ketë disa trajnime bazë dhe mund të veprojë në një kapacitet të kufizuar.
  - c) Vendosja e çantës së Ndhmës së Parë në një pozicion të arritshëm për udhëheqësit.
  - d) Një plan veprimi për qasje tek ndihma e duhur mjekësore menjëherë nëse një fëmijë ka pësuar lëndime ose sëmundje akute. Drejtuesit do të sigurojnë që prindërit të jenë të informuar dhe të mbështeten aty ku ndodhin situata të tilla.

- e) Një plan i përgjigjes emergjente për situatat e krizes ose traumës. Kjo do të përshkruajë veprimet që do të ndërmerren në mënyrë që të sigurohet mbështetje si për fëmijët dhe udhëheqësit e prekur, ashtu edhe për familjet e atyre që janë prekur, përfshirë orët dhe ditët pas një traume, dhe më gjatë nëse është e nevojshme.
9. Të respektohen të gjitha kodet e sigurisë së transportit që kanë të bëjnë me përdorimin e rrypit të sigurisë, shpejtësinë, numrin e pasagjerëve, kualifikimet e shoferëve, dhe sigurimin dhe aftësinë për rrugë të automjeteve.
10. Bëhet mbikëqyrje e standardeve të larta të higjienës:
- Përgatitja dhe servirja e ushqimit,
  - Pastërtia e të gjitha ambienteve.
11. Zbatohen nivelet e duhura të sigurimit të përgjegjësisë publike dhe janë përmbushur plotësisht të gjitha kërkesat e kompanive të sigurimeve.

## B. Kodi i Mirësjelljes për Stafin dhe Vullnetarët e Scripture Union

SU pret që drejtuesit e vet të mbajnë standarde të larta të sigurisë në çdo aktivitet që përfshin fëmijët, në përputhje me pozicionin e tyre si kujdestarë në mungesë të prindërve ose kujdestarëve.

Udhëheqësit e SU-së bien dakord që ata gjithmonë do të:

- Jenë të vëmendshëm për rreziqet e mundshme dhe do t'i bëjnë planifikimet për menaxhimin e tyre në mënyrë që të respektohen standardet ligjore dhe ato të miratuara.
- Do t'i mbrojnë fëmijët nga rreziku i panevojshëm në një mënyrë që është e përshtatshme për nivelin e rrezikut dhe për moshën dhe kompetencën e fëmijëve.
- Asnjëherë nuk do t'i lëmë fëmijët pa mbikëqyrjen e duhur e të rriturve.
- Asnjëherë nuk do ta detyrojmë një fëmijë të marrë pjesë në një aktivitet.
- Gjithmonë do të promovojmë ndërveprimin pozitiv midis fëmijëve, duke ndërhyrë kur sjellja e një fëmije mund të vërë të tjerët në rrezik.
- Gjithmonë sigurohuni që, në fund të çdo aktiviteti, një fëmijë të mos lihet të presë vetëm për prindërit / kujdestarët e vet.
- Do të njihet dhe do t'i përfill procedurat e rëna dakord në rast të një situatë traumatike. (Shihni Shtojcën 4 për Shabllonin e Formularit të Raportimit që do të përdoret për rastet e Incidenteve të Sigurisë).

## Pjesa e katërt

---

### Zhvillimi dhe zbatimi i një politike për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve brenda SU-së

Në fund të fundit është përgjegjësi e secilit Këshill ose organeve drejtuese të SU-së, që të sigurojnë që një Politikë për Mbrojtjen, Sigurinë dhe Përkujdesjen e Fëmijëve – e përshtatshme për kontekstin e tyre dhe duke përfshirë standardet minimale të përcaktuara në këtë udhëzues – të miratohet dhe zbatohet brenda lëvizjes së tyre. Kjo do të përfshijë:

#### 1. Zhvillimi i një politike.

Çdo lëvizje nacionale e SU-së duhet të zhvillojë dhe miratojë një Politikë të Mbrojtjes, Sigurisë dhe Përkujdesit të Fëmijëve duke përdorur të paktën këto standarde minimale në thelbin e saj, dhe të jetë plotësisht brenda rregulloreve të qeverisë. Lëvizjet nacionale të SU-së, që tashmë kanë një politikë të tillë në zbatim, duhet ta kontrollojnë të tyren kundrejt këtyre standardeve minimale dhe ta modifikojnë atë po të jetë e nevojshme.

#### 2. Zhvillimi i një Strategjie.

Çdo lëvizje nacionale e SU-së duhet ta miratojë një strategji realiste zbatimi që do të përfshijë:

- a) zhvillimin e sistemeve dhe procedurave të përshtatshme;
- b) bërjen e ndryshimeve në dokumente, etj, për të siguruar që ato të jenë në përputhje me standardet e reja
- c) trajnimin e të gjithë stafit dhe vullnetarëve si në miratimin fillestar të politikës ashtu edhe si një kërkesë e vazhdueshme. Trajnimi i stafit dhe vullnetarëve zakonisht do të jetë 12 deri në 24 muaj. (Shihni Formularin e Vetë-Auditimit, në Shtojcën 4, i cili mund t'ju shërbejë si një mjet i dobishëm fillestar dhe vlerësues).

#### 3. Rishikimi dhe Përmirësimi i Rregullt.

Përtej miratimit dhe zbatimit të një politike për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve, lëvizjet nacionale të SU-së duhet të sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm të pajtueshmërisë, si dhe një forcim të rregullt të kapacitetit të tyre të mbrojtjes, sigurisë dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve në një mënyrë të planifikuar dhe sistematike. Në veçanti kjo do të përfshijë:

- a) Vlerësimi i praktikës së tyre për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve, në intervale të rregullta, pas zbatimit (fillimisht çdo 6 muaj dhe 12 muaj dhe më pas çdo vit). Ajo që mësohet përmes vlerësimit duhet të ndikojë në zhvillimin e ardhshëm.
- b) Trajnime të mëtejme për stafin dhe vullnetarët për standardet e mbrojtjes, sigurisë dhe përkujdesjes së fëmijëve. (P.Sh. procedurat mund të vendosen për t'u siguruar që i gjithë personeli i ri dhe vullnetarët do të trajnohen në lëvizjet e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve, dhe / ose që gjatë vitit të ardhshëm, personeli kryesor i fushës do të marrë trajnim specifik në fushën e vlerësimit dhe minimizimit të rrezikut gjatë aktiviteteve të SU-së, etj).
- c) Zhvillimi i mëtejshëm i sistemeve, procedurave, pajisjeve dhe vetive (të tilla si vendet për kamping), për të siguruar sigurinë e lartë dhe standardet tjera. (P.Sh. një lëvizje e SU-së mund të vendosë që gjatë vitit të ardhshëm, i gjithë stafi i terrenit të trajnohet në dhënien e Ndihmës së

Parë bazë si një çështje e politikës, dhe / ose fushat e përgatitjes së ushqimit dhe praktikave në vendet e kampingut do të përmirësohen, etj).

- d) Nxitjen e një kulture që promovon ndërgjegjësim të vazhdueshëm të rrezikut dhe mënyrën se si mund të menaxhohet në të gjitha aktivitetet e SU-së.

## Përmbyllje

---

Detyra e zhvillimit, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të një politike për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve, është një angazhim shumë domethënës për çdo lëvizje të SU-së. Do të përfshijë mençuri, përkushtim dhe vullnetin e mirë e të gjitha palëve të përfshira. Disa lëvizje të SU-së do ta zbulojnë se përbushja e këtij synimi do të kërkojë udhëzim dhe ndihmë nga jashtë lëvizjes së tyre dhe kështu, nëse është e nevojshme mund të ftohen Drejtorët e Zhvillimit të Terrenit të SU-së dhe specialistët e shërbesës,

Sigurimi i mbrojtjes dhe sigurisë së fëmijëve që ndodhen nën kujdesin tonë, është një detyrim themelor i SU-së, në të gjitha nivelet e organizatës. Është një privilegj dhe njëkohësisht përgjegjësi që t'i përkushtohemi kësaj si njerëz të Mbretërisë së Perëndisë dhe kështu është i denjë për angazhimin e thellë dhe përpjekjen më të mirë të të gjithë atyre që punojnë me Scripture Union, në të gjithë botën. Përputhja me standardet e qeverisjes tuaj kombëtare është thelbësore. Ne e sjellim në pak këtë iniciativë për vëmendjen e Këshillave, organeve drejtuese dhe njerëzve të SU-së.

## Shtojca 1: Abuzimi dhe Abuzuesit

---

### Përkufizimet e Abuzimit

Abuzimi është një term i përgjithshëm për të përshkruar sjellje të papërshtatshme, joetike dhe / ose të pa moralshme, nga një i rritur ndaj një fëmije ose të një fëmije ndaj një fëmije tjetër, atëherë kur ekziston një ndryshim në fuqi bazuar në moshën ose aftësinë fizike, intelektuale ose emocionale.

Ekzistojnë 5 lloje kryesore të abuzimit:

#### 1. Neglizhimi

Dështimi i një prindi, ofruesit të përkujdesjes ose kujdestarit, për të siguruar nevojat themelore të fëmijës për arsye të tjera përveç rastit të shëndetit mendor, varfërisë ose luftës.

#### 2. Abuzimi fizik

Lëndim aktual ose në tentativë i një fëmije ose dështim i qëllimshëm për të parandaluar ose injoruar një dëmtim të tillë. Grushtimi, rrahja, shqelmimi, shkundja, goditja, djegia, dhënia e fëmijëve alkool ose ilaçe të papërshtatshme, bëjnë pjesë në këtë kategori.

#### 3. Abuzimi seksual

Detyrimi ose joshja e një fëmije për të marrë pjesë në aktivitete seksuale ose të sigurojë zgjim ose kënaqësi seksuale për një tjetër, pavarësisht nëse fëmija është i vetëdijshëm për atë që po ndodh.

Abuzimi seksual mund të përfshijë:

- a) Kontaktin fizik, përfshirë veprimet penetruese ose jo-penetruese.
- b) Aktivitete pa kontakt, të tilla si përfshirja e fëmijëve në shikimin e materialeve pornografike, ose nxitja e fëmijëve të sillen në mënyra jo të duhura seksuale.
- c) Biseda të papërshtatshme, siç janë referencat, shakatë dhe thashethemet me përmbajtje seksuale.
- d) Ngacmimi seksual: bullizmi ose detyrimi i një natyre seksuale dhe premtimi i padëshiruar ose i papërshtatshëm i shpërblimeve në këmbim të favoreve seksuale.

#### 4. Abuzimi emocional

Shkaktimi i frikës tek fëmijët, ndjesia se janë në rrezik, të korruptuar, të pavlefshëm, të padashur ose të paduhur. Çdo gjë që përfshin ushtrimin e pushtetit të pakufizuar ndaj një personi më pak të fuqishëm, duke përfshirë – ngacmimin, kritikën e vazhdueshme, abuzimin verbal, pritjet e papërshtatshme, refuzimi.

#### 5. Abuzimi shpirtëror

Shtërngimi, kontrollimi ose manipulimi i një fëmije nga një udhëheqës shpirtëror, zakonisht si pasojë e nevojës së udhëheqësit për njohje dhe pushtet. Abuzimi shpirtëror ushtrohet përmes keqpërdorimit të autoritetit ose besimit, përmes kërcënimeve ose presionit për t'u përshtatur me pritjet e udhëheqësit.

Shembujt përfshijnë:

- a) Përdorimi i pozicionit tonë për ta bërë një fëmijë të ndjehet se ai / ajo duhet të thotë / bëjë diçka që të jetë i / e pranuar për ne.
- b) Rritja e një ndjesie dështimi ose turpi nëse fëmijët nuk i përshtaten planprogramit tonë shpirtëror.
- c) Paraqitja e mesazheve krishtere në mënyra që janë jashtëzakonisht emocionale ose të bazuara në frikë.

- d) Mosrespektimi i lirisë së fëmijës për ta shprehur besimin e tij/saj; mosrespektimi i pyetjeve të tyre ose nevojës së tyre për shpjegime racionale; ose përjashtimi i fëmijëve mbi bazën e përkatësisë së tyre fetare.

### Dëmtimi i vetvetes

Kjo ndodh kur një fëmijë qëllimisht e prenë ose dëmton veten e tij, shpesh herë si pasojë e stresit të tejtrënduar emocional. Edhe pse zakonisht nuk përbën një përpjekje për vetëvrasje, shumë të atillë që e dëmtojnë vetën e tyre, ka më shumë të ngjarë të provojnë vetëvrasje në një fazë të mëvonshme. Nëse një fëmijë që e ka dëmtuar vetveten nuk e merr mbështetjen e nevojshme menjëherë, atëherë Scripture Union këshillohet ta referojë fëmijën – zakonisht përmes familjes së tyre – për në shkallën e parë, për të kërkuar ndihmë. Në rastet kur familja i reziston referimit, SU këshillohet që ta referojë fëmijën tek autoritetet përkatëse.

### Abuzuesit

Si të rriturit ashtu dhe fëmijët janë abuzues potencial të fëmijëve.

Abuzuesit kërkojnë t'u qasen fëmijëve përmes sportit, rekreacionit dhe punës rezidenciale dhe, kështu, Scripture Union është veçanërisht i cënueshëm.

Abuzuesit rrallë herë janë të huaj. Në shumicën e rasteve, ata janë njerëz të njohur për fëmijën.

## SHTOJCA 2: Shablloni i Formularit – Puna në Scripture Union

Shpjegim në lidhje me formularin e më poshtëm:

Nëse një person nuk përzgjedh kutitë 2 dhe 3, kjo nuk i përjashton ata domosdoshmërisht nga shërbimi me SU-në. Nevojitet një bisedë përcjellëse. Për shembull:

Nën pikën 2, nëse pas shqyrtimit të kujdesshëm vendoset se ka prova të mjaftueshme se pretendimi është i pabazuar, personi mund të pranohet.

Nën pikën 3, një vendim merret në varësi të dënimit. Për shembull, nëse dënimi ka të bëjë me një vepër serioze të vositjes, SU mund të përjashtojë personin nga vazitja për aktivitetet e SU-së por jo nga aktivitetet e tjera në SU. Çdo shkelje në lidhje me fëmijët, pavarësisht vjetërsisë së rastit, e përjashton një person nga përfshirja me SU-në.

<b>Deklaratë për mbrojtjen e fëmijëve nga stafi dhe vullnetarët e SU-së</b>	
Emri:	
Zona e Aktivitetit / shërbesës	
Adresa	
Adresa e emailit	
Numri i celularit	
Numri i telefonisë fikse	
Unë jam <input type="checkbox"/> Anëtar i stafit <input type="checkbox"/> Vullnetar	
<p>Unë _____ (emri) deklaroj se:</p> <p><input type="checkbox"/> 1. E kam lexuar Kodin e Mirësjelljes për Stafin dhe Vullnetarët e Scripture Union dhe pajtohem t’ju përmbahem standardeve, udhëzimeve dhe procedurave të tij.</p> <p><input type="checkbox"/> 2. Asnjëherë nuk jam akuzuar për ndonjë sjellje të papërshtatshme me ndonjë fëmijë.</p> <p><input type="checkbox"/> 3. Unë kurrë nuk jam dënuar, dhe as kam ndonjë dënim në pritje si dhe nuk kam njohuri për ndonjë incident ose ngjarje në lidhje me veten time, e cila ka potencialin për ta sjellë Scripture Union në situatë denigruese.</p> <p><input type="checkbox"/> 4. Pajtohem se është përgjegjësia ime t’i mbaj konfidenciale të gjitha informacionet në lidhje me një fëmijë të dyshuar për abuzim, përveç informimit të minimumit tejet të kufizuar të njerëzve që unë duhet t’i njoftoj, dhe që është në pajtim me procedurat e kërkuara.</p>	
Nënshkrimi:	Data:

**SHTOJCA 3:**
**Shablloni i Formularit të Raportimit – Zbulimi i Abuzimit ose Abuzimit të Dyshuar**

## **KONFIDENCIALE**

### **FORMULAR RAPORTIMI**

#### **ZBULIM I DËMTIMIT OSE ABUZIMIT OSE DYSHIMIT PËR DËMTIM OSE ABUZIM LIDHUR ME PJESËMARRËSIT NË PROGRAMET E SU-SË**

Ky Formular është një procesverbal që ruhet dhe që duhet të plotësohet nga përgjegjësi i lart, në vendngjarje, në kohën kur ka ndodhur zbulimi. Duhet të plotësohet sa më shpejt të jetë e mundur, jo më gjatë se 3 orë pas zbulimit të rastit.

**ME RËNDËSI:** Nuk duhet plotësuar në praninë e fëmijës ose të riut në fjalë.

Emri i Programit të SU-së			
Emri i Drejtorit të Programit / Udhëheqësit			
Vendndodhja e programit			
A është njoftuar Drejtori Kombëtar ose stafi i lartë ose zyrtari për mbrojtjen e fëmijëve?			
Po <input type="checkbox"/>		Jo <input type="checkbox"/>	
<b>Sesioni A: Të dhënat e personit që e plotëson Formularin</b>			
Emri			
Roli në kamp / program			
Adresa			
Data e lindjes		Gjinia	
Numri i telefonit kontaktues			
<b>Sesioni B: Detajet e fëmijës/ të riut</b> <i>(Këto të dhëna mund të sigurohen edhe prej drejtuesit i programit)</i>			
Emri			
Data e lindjes		Gjinia	
Numri i telefonit kontaktues			





SCRIPTURE UNION

Adresa							
Shkolla	Klasa						
A kërkon fëmija /i riu përkujdesje mjekësore?		Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>		
<b>Seksioni C: Zbulimi i dëmit</b>							
Lutemi që në hapësirën e mëposhtme të paraqitni informacione të sakta e faktike. Informacioni duhet të përfshijë vetëm ngjarjet e vëzhguara, informacionet e marra nga fëmija, ndonjë shenjë dalluese fizike, ose ndryshime përkatëse në sjelljen e një fëmije, të cilat mund të ndihmojnë që në të ardhmen të ofrhet siguria fëmijës / personit të ri.							
Data dhe koha kur dëmi i supozuar / dyshuar u vu re ose u zbulua për herë të parë?							
Data		Koha		Para dite / Pas dite			
Lutemi specifikoni natyrën-at e dëmit të supozuar / dyshuar							
<input type="checkbox"/> Fizik		<input type="checkbox"/> Seksual		<input type="checkbox"/> Emocional			
<input type="checkbox"/> Neglizhim		<input type="checkbox"/> Psikologjik		<input type="checkbox"/> Dëmtim i vetvetes			
Ju lutemi përshkruani detajet e incidentit të supozuar (nëse kjo hapësirë është e pamjaftueshme, lutemi të bashkangjitni informacione fletë tjera).							
A supozoni se fëmija rrezikon të dëmtime të mëtutjeshme?				<input type="checkbox"/>	Po	<input type="checkbox"/>	Jo
Nëse po, lutemi jepni arsye faktike për dyshimin tuaj.							

SHTOJCA 4:

Shabllon Formulari Raportimi – Incident / Aksident (jo për dyshime abuzimi)

**FORMULARI RAPORTIMI – MENAXHIM I INCIDENTEVE / AKSIDENTEVE**

Ky Formular është një procesverbal që duhet të plotësohet nga përgjegjësi i lart, në vendngjarje në kohën e aksidentit / incidentit, dhe t'i dërgohet drejtorit kombëtar.

**Nëse incidenti është serioz, drejtori kombëtar duhet të informohet menjëherë.**

Programi:		Lokacioni:	
Aktiviteti:	Data:	Koha:	
Drejtuksi i Programit:		Numri i kontaktit:	
Përshkrim i shkurtër i incidentit:			
Mosha e individit / eve të përfshirë në incident:			
A është kërkuar ndihma e jashtme (nëse është relevante) (Policia, Zjarrfikësit, Ambulanca, Mjekësia, Etj):			
A është informuar Drejtori Kombëtar / Stafi i Lartë: <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo			

**DETAJE TË INCIDENTIT**

(Pyetjet e mëposhtme ofrojnë një udhëzues për llojin e informacionit të kërkuar për të ndihmuar në menaxhimin më efikas të kësaj dhe ofron një regjistrim të incidentit për referenca në të ardhmen)

Çfarë ka ndodhur?
Ku ka ndodhur?



SCRIPTURE UNION

<b>Kur ka ndodhur?</b>
<b>Kush ishte i përfshirë?</b>
<b>Çfarë veprimi është ndërmarrë si përgjigje?</b>
<b>Kush tjetër është kontaktuar që nga incidenti? (Prindërit, mbështetja e urgjencës, etj)</b>
<b>Detajet e kontaktit të afërmit / Gardianit:</b>
<b>Çfarë po ndodh me pjesën tjetër të pjesëmarrësve / ekipit?</b>
<b>A ka ndonjë nevojë të veçantë? (Këshillim, Personel Mbështetës, Transport, Pajisje, Ushqim)</b>
<b>Çfarë niveli i aktivitetit mediatik po ndodh? (Nëse ndonjë)</b>
<b>A ka ndonjë gjë tjetër që Udhëheqja e SU-së duhet ta dijë?</b>

## REGJISTËR I KONTAKTIT DHE AKTIVITETIT

(Plotësoni këtë regjistër nëse janë bërë ose marrë telefonata për reagim të shpejtë, si një regjistër i të gjitha veprimeve të ndërmarra dhe kontakteve me njerëzit. Bëni atë sa më të detajuar sa të jetë e nevojshme)

Data dhe koha	Informacioni i ndarë, udhëzimet e dhëna, vendimet e marra, etj

## Shtojca 5

### Mbrojtja, Siguria dhe Përkujdesja e Fëmijëve: formë vetëvlerësimi për lëvizjet kombëtare të SU-së

(Huazuar nga "Keeping Children Safe: Tearfund and partners")

	E kryer	Pjesëri sht e kryer	E pa kryer
<b>A. Fëmijët dhe SU</b>			
1. SU e ka një deklaratë të përkushtimit për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve			
2. Kodi i Mirësjelljes e përshkruan mënyrën e sjelljes së personelit dhe vullnetarëve ndaj fëmijëve dhe i bën ata të zotohen që ata të respektojnë të gjithë fëmijët dhe t'i mbrojnë ata nga abuzimi.			
3. Politika e mbrojtjes, sigurisë dhe përkujdesjes së fëmijëve e SU-së, e bën të qartë se të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre.			
4. Të gjitha masat disiplinore janë jo të dhunshme dhe nuk i poshtërojnë fëmijët.			
<b>B. Politikat dhe procedurat</b>			
1. SU ka një politikë të qartë të mbrojtjes, sigurisë dhe përkujdesjes së fëmijëve, që përputhet me politikat ndërkombëtare dhe kombëtare të SU-së.			
2. Politika i përfshin të gjitha kërkesat ligjore dhe kulturore të shtetit ku operon.			
3. Politika është miratuar nga Këshilli/Bordi kombëtar i SU-së dhe personeli i lartë.			
4. Politika është e detyrueshme për të gjithë stafin dhe vullnetarët e SU-së.			
5. Ekzistojnë hapa të qartë për të adresuar shqetësimet në lidhje me sigurinë e fëmijëve.			
6. Ekziston një person i caktuar në SU i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve në çdo nivel, përfshirë zbatimin e masave të sigurisë dhe sistemet.			
<b>C. Praktikrat e mira dhe parandalimet</b>			
1. Ekziston një Kod i Mirësjelljes për të gjithë stafin dhe vullnetarët e SU-së që përshkruan atë që është e pranueshme dhe e papranueshme në sjelljen ndaj fëmijëve.			
2. Ka pasoja të qarta që përcaktohen për thyerjen e këtyre udhëzimeve.			
3. Ekzistojnë procedura të vendosura për të vlerësuar përshtatshmërinë e atyre që kërkojnë të punojnë me fëmijë në SU.			
4. Mbikëqyrja dhe mbrojtja e duhur sigurohet në të gjitha aktivitetet.			
5. Ka mënyra të reklamuar mirë në të cilat njerëzit mund të ngrenë shqetësime në lidhje me çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, por, duke e ruajtur konfidencialitetin.			
<b>D. Zbatimi dhe Trajnimi</b>			
1. Ka udhëzime të qarta për stafin se si politika do të zbatohet dhe përshtatet praktikisht për rrethanat e ndryshme.			
2. Ekziston një program trajnimi për të njohur të gjithë stafin dhe vullnetarët me politikat dhe procedurat e mbrojtjes, sigurisë dhe përkujdesjes së fëmijëve.			
3. Ekziston një program trajnimi që familjarizon të gjithë stafin dhe vullnetarët se si t'i dallojnë shenjat e abuzimit të fëmijëve.			
4. Është bërë punë me të gjithë partnerët për të rënë dakord mbi standardet e larta të sigurisë për mbrojtjen, sigurinë dhe përkujdesjen e fëmijëve kur punoni me ose përmes agjencive të tjera.			
<b>E. Informacioni dhe komunikimi</b>			



SCRIPTURE UNION

1. Ngjarjet dhe aktivitetet e SU-së organizohen në atë frymë që i bën fëmijët dhe të rriturit të ndjehen të sigurt për të raportuar shqetësimet dhe janë të vetëdijshëm për të drejtën e tyre për ta bërë këtë gjë.			
2. Detajet e kontaktit janë lehtësisht të disponueshme për autoritetet përkatëse të mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet e këshillimit dhe ndihmës së urgjencës mjekësore.			
<b>F. Monitorimi dhe Rishikimi</b>			
1. Ekzistojnë rregulla për të monitoruar zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve.			
2. Të gjitha incidentet e abuzimit dhe ankesat regjistrohen dhe ndiqen në përputhje me procedurat e rëna dakord.			
3. Ekzistojnë mekanizmat për rishikimin dhe përditësimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve, çdo 3 vjet.			